



Janina

Gregi

një sytet...

shumë drejtime



Një shëtitje në qytet

Takim në Sheshin Qendror të qytetit "Mbreti Piros", para ndërtesës karakteristike administrative të qytetit, të Prefekturës. Pas ndërtesës, shtrihet qendras moderne tregtare e shtruar për këmbësorët, dyqanet e së cilës ofrojnë një sërë zgjedhjesh. Një ndalesë e domosdoshme në kafet-bistro. Dhe sytë tuaj hapur. Diku mes vitrinave dhe



dyqaneve, takon kushdo thesare te vogla kulturore dhe monumente arkitekturë: që nga Muzeumi Folklorik i Shoqatës së Studimeve Epirote, ndërtesën e Postës dhe Bibliotekën Zosimea deri te ish-shkolla e Endësve Papazoglio, ish-shkollën Kapllanio dhe vilën Pirsinella. Para se të lini sheshin qendror modern të shtruar për këmbësorë mos harroni Muzeun Arkeologjik të Janinës të njojur botërisht, një ndërtesë-krijesë e arkitektit të shquar Ari Konstandinidhi, i cili ndodhet te parku "Litharica", përbashkët me Bashkisë. Në Muzeun do të keni rastin të "udhëtoni" në qytetet e lashta të Epirit. Nga "Litharica", dikur llogare e Ali Pashës, mund të shijoni nga lart pjesë të qendrës historike dhe të liqenit. Dhe meqë nisi shëtitja nga e kaluara



otomane e qytetit, shkoni pak më tutje, që të shikoni xhaminë dhe medresetë e Veli Pashait, por edhe xhaminë e Kalluçanit, në minaren e së cilës, po të keni fat, do të shikoni një lejlek që çlodhet. Kthehemë drejt qendrës së qytetit, dhe që andej në Galerinë Publike. Mund të mos jetë e madhe, por përbën një bërthamë të rëndësishme kulturore të qytetit. Mund të lodheni pak duke ecur, por ia vlen.




Një shëtitje në Qendrën Historike

Një shëtitje në Qendrën Historike, e cila shtrihet në "ballë" të qytetit drejt liqenit, vlen vetëm nëse keni dëshirë të ngatërroheni dhe të humbisni. Një pikënisje e mirë për këtë shëtitje është Sahati i sheshit (1905), përbashkët me Bashkisë. Zbrisni rrugën qendrore, ku do të gjeni dyqane argjendarie dhe dyqane me artikuj të artit popullor dhe suvenire dhe lini enstiktin t'ju udhëtoj. Majtas dhe djathtas rrugës qendrore, në çdo rrugicë, në çdo ngushticë dhe një e papritur. Një labirint i vogël ndërtesash të mbajtura, qendra të vogla tregtare, hane, shtëpi të vjetra popullore dhe rrugë këmbësorësh. Baraqe dhe kafeteri ju presin duke provuar rakinë tradicionale me meze të zgjedhura të vendit, para se të vazhdoni shëtitjen tuaj në Janinën e shekujve të kaluar.



Një shëtitje në kala (kështjellë)

Nuk ka rëndësi se cilën portë do të zgjidhni për të hyrë brenda. Sapo hyni brenda qytetit-kështjellë zhurma e qytetit mbetet pérjashta. Një vendbanim tradicional ku aty- këtu brenda tij ka ndërtesa otomane, si: Sufari Serai dhe xhamia Asllan Pasha që strehon Muzeun Publik, por edhe Sinagogën Hebraike. Një udhëkryq kulturash dhe fesh. Dhe lart, Iç Kaleja, Akropoli: një park i vogël kulturor me Muzeume dhe Përgjedhje.



liqe
nit. Në pikë kyçë të këtij udhëkalimi janë ngritur shumë restorante dhe kafeteri. Afër Bregut Mjauli është dhe Qendra Tradicionale Artizanale e Janinës, ku mund të gjeni stolira dhe çdo krijim tjetër të argjendarisë. Një shëtitje me këmbë ose bicikletë buzë liqenit të bëhet domosdoshme. Gjithë sa jeni "amator" të peshkimit ose të "bird watching", mos harroni pajisjet tuaja.




tradita dhe legjenda. Një shëtitje shumë e mirë është kalimi i ishullit me këmbë që do t'ju kënaqë dhe do t'ju hapë oreksin për të shijuar specialitetet vendase, si: këmbë bretkosash, ngjala, karavidha etj.



Një shëtitje në Ishull

Varkat e vogla të lidhura në Molos, ju drejtojnë për në Ishull, një vend që kurrë nuk morri emër tjetër. Thjesht Ishulli. Aty shtëpia e Ali Pashait, aty edhe një kompleks monumentesh kishëtare: Kisha Filantropike (1291), Kisha Stratigopullu (shek. i 13-të), Kisha e Shën Mërisë Eleusës (shek. i 16-të). Banorët e Ishullit gjithnjë gati t'ju tregojnë histori,



Një shëtitje jashtë Janinës

Pesëmbëdhjetë kilometra jashtë Janinës ndodhet qendra arkeologjike e Dhodhonit, një vend që e rrethon ndjenja. Vitet e fundit, bëhen përpjekje për rindërtimin e teatrit antik dhe monumenteve të tjera, me shpresën se një ditë do të dëgjohen përsëri zërat e aktorëve të mëdhenj. Afër qytetit, në Bizan, është dhe Muzeumi i Portretëve të Derdhura në Qiri, i vetmi i këtij lloji në krejt vendin. Para se të largohemi nga qyteti, mos harroni të vizitoni Shpellën e Peramës për një udhëtim në shpellat e nëndheshme. Në Perama mund të bëni dhe një ndalesë për të shijuar meze tradicionale dhe raki. Lidhet gjithashtu edhe me rrugë ujore me ishullthin. Me vlerë është edhe një shëtitje në kodrën e Kastricës (në spile janë gjetur prej kohësh mbetje të organizmave të detit dhe vegla guri) dhe në Manastirin e Ioani Prodhromu (shek. i 11-të). Ia vlen gjithashtu një shëtitje në Lingjadhes për të shijuar nga lart pamjen magjike të qytetit me liqenit.



Një qytet... i shumëkulturuar

Janina zbulohet me shumë kultura dhe shumë përzgjedhje jo vetëm nëpërmjet tregimeve. Kisha me arkitekturë me vlera, xhami dhe një sinagogë, nga më të shënuarat në Greqi, tregojnë karakterin shumëkultural të qytetit. Bashkekzistenca e të krishterëve, myslimanëve dhe hebrenjëve u vendos në kohën e sundimit të Ali Pashait.



Shkëmbimi i popullsive pas katastrofës mikrasiatike dhe zhdukja e shumicës së Hebrenje nga Gjermanët, solli ndryshime në analogjinë e popullatës. Myslimanë mund të mos ketë sot në qytet dhe Hebrenjtë mund të janë të pakët, aq sa mundën të shpëtojnë nga vendqëndrimet e kampeve, por qyteti nuk hodhi në erë kurrë atë pjesë të identitetit të tij. Sot ekyistojnë katër xhami, tre prej tyre shumë mirë të mbajtura, ndërsa Sinagoga Hebraike, e ndërtuar në vitin 1826 vazhdon të jetë edhe sot ndërtesa më e madhe dhe më e bukur e ndërtesave të shpëtuara hebraike.



Një shëtitje në vendet malore

Nuk janë të pakta përzgjedhjet që keni për t'u larguar nga Janina. Zagori është vendi më i preferuar. Dhjetëra vendbanime tradicionale prej guri që ruajnë edhe sot identitetin e tyre kulturor. I ndajnë lumenj, ura prej guri, shtresime gjeologjike, humnera e Vikos. Udhëtim me këmbë në monopatet e panumërtë të Zagorit, ngjitje alpinistike në Smolita dhe në Dhrakolimni, por edhe veprimtari, si: hedhje me parashutë dhe aksione për kërpudha të egra. Dhe sigurisht "rafting" nëpër lumenj jo vetëm të Zagorit por edhe më në veri të Konicës dhe të Xhumerkës. Në Xhumerka, ku me pamjen e tyre të egër fitojnë mrekullinë e sa më shumë vizitorëve. Mecovo është një drejtim i veçantë. Një vendqëndrim tradicional vlehangë me interesa të shumta, muze, qendra skish në malet e Parkut Kombëtar të Pindit, me liqenin e mrekullueshmëri në pyjet e Vala Kaldës.



Një qytet...shumë drejtime

Me epikendër Janinën, nëpërmjet një rrjeti rrugor të përsosur, çdonjëri mund të planifikoj shëtitje ditore sa në mal aq edhe në det, me brigjet shumë të bukura të Jonit, të Sivotit, të Pargës dhe të Prevezës. Të vizitojë monumente kulturore dhe fetare me vlera të mëdha, të marrë pjesë në veprimtari sportive, të humbasë në monopate të trashëgimisë historike dhe të natyrës së papërshkruar, por edhe të shijoj gastronominë e veçantë të zonës, të argëtojë intensivisht ose të qetësohet, të bashkëjetojë traditën e mirëfilltë me mënyrën bashkëkohore të jetesës. Të jetojë çaste të "mbushura" dhe të fitojë përvoja të veçanta.



Qarku i Janinës kanjë potencial të madh për të qëuë një vendë i argëtimit, qetësimit dhe aventuravet për gjethë vitin Gjatë kohës së vjeshtës dhe dimrit turistët mund të kalojnë pushimet në një abjentë të veçantë ku u jep një llojshmëri të madhe për të bërë ski si Heli-shiing free-ride, ski drejt greminës dhe aktivitete te tjerg Pranvera dhe vera në krahinë ju afrojnë një kompleks peisazesh të mahnitshme dhe një florë të egër e të pasur. Me kafshë të egra e të rradha, lumenjë, ligene të qeta, qiell të kaltër e të pastërt. Kjo skenë e mrekullueshme ju afronë mundësi të pa numërt për pushime nga qyteti, kënaqësi gastronomike, qetësi e pamje të pa harueshme, shëtitje të mrekullueshme si dhe traditë në histori e në aktivitete të jashtme, perfshirë Hiking shëtitje me kal rafting, lundrim, çiklizëm, kanoe, sport në ujërat e liqenit, peshkim në lumenje e liqene, gjueti, camping, aktivitete në natyrë e shumë të tjera



Mbritja në Janninë

Me aeroplanë janë dy fluturime nga Athina në Ioannina International Airport çdo ditë me Aegean Airways.



Nga rruga Qyteti është 410 km nga Athina dhe 290km nga Saloniku. Nëpermjet Egnatias (autostradës, rruga ere) Ioannina -Saloniku është vetëm 2,5 orë.

Port Limani i Gumenicës është limani i tretë nga madhësia, por konsiderohet No 1 sa i perket shkëbimeve tregtare Ndodhet veri-perëndim të epirit përbollë korfuzit (18 milja) dhe shumë afër kufirit Gregisë me Shqipërinë Eshtë largë 92km larg nga Jannina (30 minuta) Pozicioni gjeografik i limanit e kthen qytetin e Gumenicës në limanin më të reudesishem tregtar n veri perëndim të Gregisë.





'Ioannina is a multicultural city with exceptional natural beauty of landscape, built on the bank of Pamvotis lake, offering many leisure opportunities. Historic & religious monuments, museums with traditional and unique exhibits, the Castle, the Island, walks in the Old City, the Market with the silverware shops as well as the alternative tourism activities options combined with exquisite gastronomic cuisine and intense nightlife, compose a promising tourist destination for all.'



**Tourism Development & Promotion Committee
Ioannina Municipality**

PL. A. Papandreou 5, 45221 – ΙΩΑΝΝΙΝΑ-GREECE
Tel.: +302651361227//+302651037017
Fax: +302651026355

www.travelioannina.com



Municipality
of Ioannina



RURAL DEVELOPMENT
PROGRAMME OF GREECE
2007-2013



European Agricultural Fund for Rural Development
Europe investing in rural areas



LEADER